



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DROPULL

KRYETARI



Nr. 819/ Prot.

Jorgucat më : 06.05.2026

## UDHËZIM

### PËR "PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR MËNYRËN E PARAQITJES SË APLIKIMIT DHE PROCEDURËN ADMINISTRATIVE PËR NJOHJEN SI POSEDUES JOPRONAR"

Në mbështetje të ligjit nr. 20/2025 "Për paketën e maleve", neni 6/4; ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar si dhe udhëzimit nr. 2, datë 15.10.2025 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shpalljes së zonës prioritare të zhvillimit në territoret e Bashkive".

## UDHËZOJ:

### I. DISPOZITA TE PERGJITHSHME

- Objekt i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave të hollësishme për mënyrën e paraqitjes së aplikimit/kërkesës dhe procedurën e brendshme administrative që ndiqet nga bashkia për njohjen e poseduesve jopronarë në zonat e shpallura si zonë zhvillimi.
- Ky udhëzim synon të ofrojë udhëzime të qarta dhe të sakta për të gjithë subjektet aplikuese në procesin e paraqitjes të kërkesës për njohjen e tyre si posedues jopronar.
- Bashkia Dropull ka si objektiv të saj kryerjen e procedurave administrative në njohjen e subjekteve kërkuese si posedues jopronar në përputhje me parashikimet ligjore të legjislacionit dhe ato që parashikohen në këtë udhëzim duke u udhëhequr nga: parimi ligjshmërisë, transparencës; objektivitetit dhe i efijencës.

## II. PARAQITJA E KËRKESËS

1. Për çdo zonë zhvillimi të shpallur ngrihet grupi teknik i punës, përbërja dhe afati i veprimtarisë i të cilit miratohet me urdhër të Kryetarit të Bashkisë. Grupi i punës do të ndjek të gjithë procesin administrativ, nga paraqitja e kërkesës deri në njohjen e subjektit kërkuar si "posedues jopronar".
2. Grupi i punës ngrihet në varësi të rrethanave të posaçme të secilës zonë të aplikuar.
3. Subjekti paraqet kërkesën e argumentuar me shkrim nëpërmjet aplikimit online në zërin e dedikuar për këtë qëllim, në portalin e-albania. Kërkesa duhet të shoqërohet me plan rilevimi të sipërfaqes së poseduar, të hartuar nga një ekspert gjeodet i licencuar.
4. Kërkesa duhet të shoqërohet me një ose më shumë nga dokumentet e mëposhtme:
  - a. Dokumentacion tatimor që vërteton ushtrimin e aktivitetit ekonomik mbi pasurinë;
  - b. Fatura të shërbimeve të lidhura me pasurinë si: pagesat për energjinë elektrike, ujë etj.;
  - c. Deklarata/dëshmi të banorëve dhe autoriteteve vendore që vërtetojnë përdorimin vazhdueshëm dhe të pandërprerë prej të paktën 10 (dhjetë) vitesh;
  - d. Fotografji, ortofoto ose prova të tjera material që vërtetojnë posedimin;
  - e. Çdo dokument tjetër i cili provon lidhjen e subjektit aplikues me pasurinë.
- 5 Mungesa e dokumentacionit provues nuk përbën shkak për refuzim, rrëzim të kërkesës apo pezullim të procedurës administrative të njohjes së subjektit kërkuar si "posedues jopronar".

## III. PROCEDURAT E VERIFIKIMIT DHE SHQYRTIMIT TË KËRKESËS

1. Pas rregjistrimit të kërkesës grupi i punës kryen verifikimin e dokumentacionit të paraqitur në çdo element të tij.
2. Në rast të mungesave të provave shkresore, grupi realizon verifikimin në terren përmes inspektimeve dhe marrjes së deklaratave/dëshmimeve nga banorë të zones dhe mban një procesverbal për këtë qëllim.
3. Procesverbali i hartuar nga grupi i punës në kuadër të verifikimit që ai kryen në terren përfshin të dhëna mbi:
  - a. Përputhshmërinë e sipërfaqes së rilevuar me gjendjen faktike;
  - b. Posedimin e vazhdueshëm dhe të pandërprerë prej të paktën 10 (dhjetë) vitesh të pasurisë;
  - c. Këshilli Bashkiak shqyrton dhe miraton listën e propozuar brenda 20 (njëzetë) ditëve nga marrja e dokumentacionit;

d. Pas miratimit të listës së poseduesve jopronarë, bashkia ose poseduesi jopronar paraqet kërkesën pranë ASHK dega vendore për pasqyrimin e poseduesit jopronar në kartelën e pasurisë përkatëse.

#### **IV. DISPOZITA TË FUNDIT**

1. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë .
2. Ky udhëzim publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë.

**KRYETARI**

**Dhimitraq Toli**

